



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
BASHKIA HIMARË

KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

Nr. 1512 prot.

Datë 21.03.2024

VENDIM

Nr. 03 datë 21.03.2024

“PËR MIRATIMIN E NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS”.

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr. 33 datë 28.07.2023, Neni 27, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 21.03.2024;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së këshillit bashkiak, e cila do të mbahet më datë 29.03.2024.
2. Ngarkohet sekretari i këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet sekretari i këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Enimoleo Gerdhaxhi  
Enimoleo

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Milto Nila  
Milto

Kryetari i Këshillit Bashkiak

( \_\_\_\_\_ )

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Oleng Memushaj  
Oleng

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

( \_\_\_\_\_ )





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

**LËNDA; BASHKËLIDHUR VENDIMIT NR 3 ,DATË 21.03.2024,MIRATUAR NGA KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK NË MBLEDHJEN E DATËS 21.03.2024 “ PËR MIRATIMIN PARAPARAK TË RENDIT TË DITËS DHE PËRCAKTIMLN E DATËS SË MBLEDHJES PËR KËSHILLIN BASHKIAK,MUAJI MARS,2024”.**

Kryesia e këshillit vendosi se mbledhja e muajt shkurt do të mbahet më datë 29.03.2024,ora 10:30, me rend dite si më poshtë;

1. Informacion mbi zbatimin e monitorimit të buxhetit për vitin 2023.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “ Për miratimin e buxhetit faktik të Bashkisë për vitin 2024”.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “ Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve buxhetore të programit buxhetor afatmesëm 2025 – 2027 dhe kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve”.
4. Shqyrtimi i projektvendimit “ Mbi transferimin në pronësi të ujësjellës kanalizimeve Himarë SH.A. Investimin me objekt ujësjellës kanalizime Sh.A ,të aseteve ujësjellës Bolenë ,Kuç ,Kallarë që të përdoren për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në njësinë Horë – Vranisht”.
5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1 – 29 shkurt 2024, nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok – ndihmës ekonomike”.

Sekretari  
Elena Memushaj

